



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në pajtim me nenin 3.5 paragrafi (ii), 15.1 paragrafi (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, nr. 28, të datës 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës drejt Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (në tekstin e mëtejme "Marrëveshja HPEA") që prej hyrjes së saj të përkohshme në fuqi në Kosovë më 10 tetor 2006,

Me qëllim të zbatimit të Direktivës 2009/12/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 11 mars 2009 mbi tarifatat e aeroportit, në kuadër të rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 mbi procedurat për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

## **RREGULLORE NR. 3/2015 MBI TARIFAT E AEROPORTIT**

### **Neni 1 Fushëveprimi**

1.1 Kjo Rregullore do të zbatohet në aeroportet e Republikës së Kosovës, organet menaxhuese të cilëve vendosin tarifa për shkak të vënies në dispozicion apo ofrimit të hapësirave dhe shërbimeve të tyre aeronautike.

1.2 Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për tarifatat e mbledhura për shërbimet e mbikalimit (en route) dhe shërbimeve terminale të navigacionit ajror në përputhje me Rregulloret nr. 14/2010 dhe 2/2011 të AAC-së, apo të tarifave të mbledhura për kompensim të shërbimeve në tokë të referuara në Aneksin e Rregullores nr. 4/2011 të AAC-së, ose për tarifatat e vendosura për financimin e asistencës për udhëtarët me aftësi të kufizuara dhe të udhëtarëve me lëvizshmëri

të reduktuar të referuara në Rregulloren e Ministrisë së Infrastrukturës nr. 2013/2 ose në Rregulloret që i ndryshojnë, plotësojnë apo zëvendësojnë të njëjtat.

## **Neni 2** **Përkufizimet**

Për qëllime të kësaj Rregulloreje:

*“Aeroport”* nënkupton çfarëdo sipërfaqe tokësore e përshtatur për aterrim, ngritje dhe manovrim të mjetit ajror, duke përfshirë instalimet ndihmëse që këto operacione mund të përfshijnë për nevojat e trafikut ajror dhe shërbimeve, përfshirë instalimet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet ajrore komerciale;

*“Organi menaxhues i aeroportit”* nënkupton një organ i cili, në bashkëveprim me aktivitetet tjera ose jo, sipas rastit, ka si objektiv të vet në bazë të ligjeve kombëtare, rregulloreve ose kontratave, administrimin dhe menaxhimin e aeroportit ose rrjetit të infrastrukturës së aeroportit dhe koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm që janë prezentë në rrjetin e aeroportit në fjalë;

*“Përdoruesi i aeroportit”* nënkupton çdo person fizik apo juridik me përgjegjësi për bartjen e udhëtarëve, postës dhe/apo mallrave përmes ajrit deri në, apo prej aeroportit në fjalë;

*“Tarifa e aeroportit”* nënkupton tarifën e mbledhur në dobi të organit menaxhues të aeroportit dhe të paguar nga përdoruesit e hapësirave dhe shërbimeve, të cilat ofrohen ekskluzivisht nga organi menaxhues i aeroportit dhe të cilat janë të ndërlidhura me aterrimin, ngritjen, ndriçimin, furnizimin me karburante, parkimin e avionëve, dhe procesimin e udhëtarëve dhe mallrave;

*“Rrjeti i aeroportit”* nënkupton një grup i aeroporteve të caktuara (dezinuara) si të tilla nga AAC-ja e Kosovës dhe të drejtuara nga i njëjti organ menaxhues i aeroportit;

*“AAC”* nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa për qëllime të Direktivës 2009/12/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 11 mars 2009 mbi tarifën e aeroportit, nënkupton organin e pavarur mbikëqyrës sipas nenit 11 të kësaj Direktive;

*“Marrëveshja PPP”* nënkupton Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat për operimin dhe zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës në mes të Republikës së Kosovës të përfaqësuar nëpërmjet Komitetit Drejtues Ndër-Ministror për Partneritetet Publiko-Private dhe “Aeroporti Ndërkombëtar Limak Kosova” Sh.A., të datës 12 gusht 2010.

### **Neni 3**

#### **Parimet themelore të tarifave**

Organi menaxhues i aeroportit duhet të respektojë parimet vijuese themelore me rastin e vënies së tarifave ndaj përdoruesve:

- a) Llogaritë e ndara që ofrojnë detaje të hollësishme të shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve, duhet të mirëmbahen gjatë gjithë kohës;
- b) Mosdiskriminimi i përdoruesve të aeroportit gjatë aplikimit të tarifave të aeroportit;
- c) Konsultimi i rregullt i përdoruesve të aeroportit në lidhje me sistemin tarifor, standardet e cilësisë dhe investimet e ardhshme.

### **Neni 4**

#### **Struktura e tarifave të aeroportit**

Struktura e tarifave të aeroportit duhet të jetë objektive dhe transparente dhe nuk duhet të inkurajojë përdoruesit që të zvogëlojnë nivelin e sigurisë.

Tarifat e aeroportit duhet të përfshijnë, në mes tjerash, si në vijim:

- a) Tarifën për aterrim, e cila mblidhet për përdorimin e hapësirave dhe shërbimeve të nevojshme për të siguruar operimet për ngritjen dhe aterrimin e një mjeti ajror. Tarifa e aterimit duhet të jetë e bazuar në formulën e peshës, duke përdorur peshën maksimale të lejuar për ngritje të mjetit ajror të përcaktuar në certifikatën e vlefshmërisë ajrore;
- b) Tarifën për parkim të mjetit ajror, e cila mblidhet për përdorimin e hapësirave të parkimit ose hangarëve. Tarifa për parkim të mjetit ajror duhet të bazohet në peshën maksimale të lejuar për ngritje të mjetit ajror, të përcaktuar në certifikatën e vlefshmërisë ajrore dhe kohëzgjatjen e parkimit të tij në aeroport. Organi menaxhues i aeroportit mund të përcaktojë kohën kur parkimi është pa pagesë;
- c) Tarifën e shërbimit të udhëtarëve, e cila mblidhet për përdorim të hapësirave të aeroportit të dedikuara për udhëtarë. Tarifa e shërbimit të udhëtarëve duhet të paguhet nga secili person që udhëton me fluturim komercial nga Kosova, përveç nëse ky person:
  - i. Është nën moshën 2 vjeçare,
  - ii. Është anëtar i ekuipazhit të kabinës në detyrë,

- iii. Pa dëshirën e tij ka arritur në Kosovë, për shkak të ndërrimit të itinerarit të fluturimit,
- iv. Është udhëtar në transit të drejtpërdrejtë (gjatë rrugës bën një ndalje në aeroport për të vazhduar me të njëjtin mjet ajror dhe me të njëjtin numër fluturimi) ose
- v. Është udhëtar me biletë falas ose me çmim të reduktuar (ID ose ZED);

Kjo tarifë mblidhet nga kompanitë ajrore, të cilat ofrojnë fluturime komerciale, në momentin e shitjes së biletave të fluturimit;

- d) Tarifën e sigurimit (security) e cila mblidhet për ofrimin e shërbimeve dhe pajisjeve të sigurimit për trafikun ajror. Tarifa e sigurimit duhet të paguhet nga secili person që udhëton me fluturim komercial nga Kosova, përveç nëse ai person i takon njërës nga kategoritë e personave që përjashtohen, siç ceket më lart në pikën (c);

Kjo tarifë mund të jetë e integruar në tarifën e shërbimit të udhëtarëve;

- e) Tarifën e urës ajrore, e cila është e ndërlidhur me ofrimin dhe operimin e urave ajrore. Tarifa e urave ajrore duhet të bazohet në periudhën kohore në të cilën kjo urë është përdorur.

## **Neni 5 Rrjeti i aeroportit**

AAC-ja mund t'i lejojë organit menaxhues të aeroportit të një rrjeti të aeroporteve të vendosë një sistem të përbashkët dhe transparent të tarifave të aeroportit për të mbuluar rrjetin e aeroporteve.

## **Neni 6 Sistemet e përbashkëta të tarifave**

Në përputhje me Marrëveshjen HPEA dhe pasi që të njoftohet Komisioni Evropian, AAC-ja mund të lejojë organin menaxhues të aeroportit të zbatojë një sistem të përbashkët dhe transparent të tarifave në aeroportet që shërbejnë të njëjtin qytet apo zonë ndërrurbane, me kusht që çdo aeroport t'i respektojë plotësisht kriteret e transparencës të dhëna në nenin 11.

## **Neni 7 Ndryshimi i tarifave të aeroportit**

7.1 Organi menaxhues i aeroportit mund të ndryshojë cilësinë dhe fushëveprimin e

ndonjë shërbimi të veçantë të aeroportit, terminaleve apo pjesëve të terminaleve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të përshtatura, apo një terminali të dedikuar apo ndonjë pjese terminali.

- 7.2 Niveli i tarifave të aeroportit mund të ndryshohet sipas cilësisë dhe fushëveprimit të shërbimeve të tilla si dhe sipas kostos së tyre, apo ndonjë justifikimi tjetër objektiv dhe transparent. Organi menaxhues i aeroportit mund të propozojë ndonjë tarifë të tillë të ndryshuar të aeroportit në pajtim me nenin 3.
- 7.3 Organi menaxhues i një aeroporti duhet të dorëzojë propozimin e tarifave të ndryshuara për aprovim në AAC në pajtueshmëri me nenet 12 dhe 13 të kësaj Rregulloreje.
- 7.4 Organi menaxhues i aeroportit duhet të lejojë cilindo përdorues, i cili dëshiron të përdorë shërbimet e përshtatura apo terminalin e dedikuar ose një pjesë të terminalit, që të ketë qasje në këto shërbime dhe në terminal apo në një pjesë të terminalit. Në rast se disa përdorues dëshirojnë që të kenë qasje në shërbimet e përshtatura dhe/ose një terminal të dedikuar apo një pjese të terminalit për më shumë sesa është e mundur për shkak të kapaciteteve të kufizuara, qasja duhet të përcaktohet në bazë të kriterëve relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese. Organi menaxhues i aeroportit duhet t'i dorëzojë këto kriterë në AAC për aprovim.

## **Neni 8**

### **Modulimi i tarifave të aeroportit**

Organi menaxhues i aeroportit mund të propozojë tarifa të moduluara të aeroportit për çështje të interesit publik dhe atij të përgjithshëm. Kriteret e përdorura për një modulim të tillë duhen të jenë relevante, objektive dhe transparente. Një modulim i tillë duhet të jetë i kufizuar në kohë, përderisa lartësia dhe kohëzgjatja duhet të jenë proporcionale me objektivin e tij.

Një modulim i tillë duhet të ketë për qëllim:

- a) Zvogëlimin apo përmirësimin e ndikimeve mjedisore dhe në këtë rast tarifa e aterimit mund të modullohet duke pasur parasysh periudhën e ditës dhe performancën e mjetit ajror sa i përket akustikës dhe emetimit të gazrave;
- b) Përmirësimin e përdorimit të hapësirave të aeroportit dhe në këtë rast tarifat e aeroportit mund të modullohen duke pasur parasysh periudhën ditore, periudhën javore apo periudhën vjetore, llojin e trafikut, mënyra se si janë përdorur hapësirat ose ku gjenden ato; apo
- c) Promovimin e hapjes së linjave të reja dhe në këtë rast tarifat e aeroportit

mund të zvogëlohen përkohësisht për përdoruesit të cilët operojnë me linjat e reja nga aeroporti në fjalë, dhe ku zona përfshirëse e klientëve në fjalë nuk interferon me asnjërën zonë përfshirëse të klientëve që shërbehen nga linjat ekzistuese.

## **Neni 9**

### **Standardet e cilësisë**

- 9.1 Organi menaxhues i aeroportit duhet të themelojë një sistem të indikatorëve të standardeve të cilësisë, në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara në aeroport. Organi menaxhues i aeroportit duhet të dorëzojë për aprovim në AAC sistemin e indikatorëve të standardeve të cilësisë. Organi menaxhues i aeroportit duhet të monitorojë indikatorët e standardeve të cilësisë dhe t'i publikojë rezultatet e tyre të paktën një herë në vit. Sa i përket Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", standardet e cilësisë duhet të vendosen sipas Marrëveshjes PPP.
- 9.2 Për të siguruar operime të rregullta dhe efikase në aeroport, organi menaxhues i aeroportit dhe përfaqësuesit ose shoqatat e përdoruesve të aeroportit mund të hyjnë në negociata me synim për të lidhur një marrëveshje për nivelin e shërbimit në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar në aeroport. Këto negociata për cilësinë e shërbimit mund të kryhen si pjesë e konsultimeve të cekura në nenin 10.
- 9.3 Çdo marrëveshje e tillë për nivelin e shërbimit përcakton nivelin e shërbimit që do të ofrohet nga organi menaxhues i aeroportit i cili merr parasysh sistemin aktual apo shkallën e tarifave të aeroportit dhe nivelin e shërbimit të cilin përdoruesit e aeroportit kanë të drejtë ta kërkojnë si kompensim për tarifën e aeroportit.

## **Neni 10**

### **Konsultimi**

- 10.1 Çdo aeroport duhet të ketë Komitetin Konsultativ (tani e tutje "komiteti") të përbërë nga përfaqësuesit e organit menaxhues të aeroportit, përdoruesit e aeroportit dhe asociacionet e transportit ajror. Përdoruesit e aeroportit dhe asociacionet e transportit ajror do të përfaqësohen me të njëjtin numër sikurse përfaqësuesit e organit menaxhues të aeroportit.
- 10.2 Organi menaxhues i aeroportit duhet ta themelojë këtë komitet, t'i përcaktojë kriteret për përbërjen e tij dhe duhet ta dorëzojë dokumentin e themelimit në AAC për aprovim final.

- 10.3 Komiteti do të hartojë rregullat e punës (termat e referencës) së komitetit në takimin e tij inaugurues të cilat duhet të dorëzohen për aprovim final në AAC. E njëjta procedurë zbatohet edhe në rast të ndryshimit apo plotësimit të tyre.
- 10.4 AAC-ja mund të marrë pjesë në takimet e komitetit, por pa të drejtë vote. Ky komitet duhet të takohet së paku një (1) herë në vit, përveç nëse palët pjesëmarrëse janë dakorduar ndryshe në konsultimet e tyre me qëllim të diskutimit lidhur me tarifat e aeroportit dhe planet investuese. Komiteti mund të konsultohet për çfarëdo çështje që ka të bëjë me tarifat e aeroportit. Procesverbali i mbledhjes së komitetit duhet të përpilohet për çdo takim.
- 10.5 Në rast se ekziston ndonjë marrëveshje shumë-vjeçare mes organit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit, konsultimet do të zhvillohen ashtu siç është paraparë me marrëveshjen e tillë. AAC-ja rezervon të drejtën për të kërkuar konsultime më të shpeshta nga ato të parapara në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni.
- 10.6 Organi menaxhues i aeroportit duhet ta dorëzojë çdo propozim për modifikimin e sistemit apo nivelit të tarifave të aeroportit në komitet, me arsyetime të justifikuara në mënyrë të duhur së paku katër (4) muaj para datës së planifikuar të hyrjes në fuqi, përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat duhet të justifikohen para përdoruesve të aeroportit. Së bashku me këtë propozim, organi menaxhues i aeroportit mund t'i dorëzojë komitetit edhe marrëveshjen për nivelin e shërbimit. Propozimi duhet të dërgohet njëkohësisht në AAC së paku katër (4) muaj para datës së planifikuar të hyrjes në fuqi të tarifave, përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat duhet të justifikohen para AAC-së.
- 10.7 Organi menaxhues i aeroportit duhet të konsultohet me komitetin para se plani i ri për projektet e infrastrukturës të jetë finalizuar.

## **Neni 11** **Transparenca**

11.1 Organi menaxhues i aeroportit duhet t'u ofrojë anëtarëve të Komitetit informata të detajuara për komponentët që shërbejnë si bazë për përcaktimin e sistemit apo nivelit të të gjitha tarifave të cilat vendosen nga organi menaxhues i aeroportit.

Informatat duhet të përfshijnë së paku:

- a) Një listë të shërbimeve të ndryshme dhe infrastrukturës së ofruar në këmbim për tarifat e mbledhura nga aeroporti;

- b) Metodologjinë e përdorur për përcaktimin e tarifave të aeroportit;
- c) Strukturën e kostos së përgjithshme në lidhje me hapësirat dhe shërbimet të cilat ndërlidhen me tarifat e aeroportit;
- d) Të hyrat nga tarifat e ndryshme dhe kostoja e përgjithshme e shërbimeve të mbuluara nga ato;
- e) Çdo financim nga autoritetet publike të hapësirave dhe shërbimeve të cilat ndërlidhen me tarifat e aeroportit;
- f) Parashikimet në aeroport që ndërlidhen me tarifat, rritjen e trafikut dhe investimet e propozuara;
- g) Përdorimin aktual të infrastrukturës dhe pajisjeve të aeroportit përgjatë një periudhe të dhënë;
- h) Rezultatin e parashikuar për secilin investim kapital dhe efektin e tij në kapacitetin e aeroportit; dhe
- i) Rezultatet e aplikimit të skemës nxitëse pasi që të jetë aplikuar tarifa e moduluar.

11.2 Kur të mbledhet komiteti për të ofruar mendimin e vet në lidhje me tarifat e aeroportit, përfaqësuesit e përdoruesve në këtë komitet duhet të dorëzojnë informata tek organi menaxhues i aeroportit, në veçanti lidhur me:

- a) Parashikimet në lidhje me trafikun;
- b) Parashikimet në lidhje me përbërjen dhe përdorimin e flotës;
- c) Projektet e tyre zhvillimore në aeroportin në fjalë; dhe
- d) Kërkesat e tyre nga aeroporti në fjalë.

11.3 Informatat e ofruara në bazë të këtij neni do të konsiderohen si konfidenciale ose ekonomikisht të ndjeshme dhe duhet të trajtohen në mënyrë përkatëse.

## **Neni 12**

### **Dorëzimi i propozimit final në AAC**

Organi menaxhues i aeroportit duhet të dorëzojë në AAC propozimin final të sistemit të ri të tarifave të aeroportit, nivelet e tyre, ndryshimin ose modulimin, nëse është i aplikueshëm, së paku dy (2) muaj para datës së hyrjes së planifikuar të tyre në fuqi. Ky propozim do të shoqërohet me dokumentet si në vijim:

- a) Objektivi i shpenzimeve operuese;



- b) Parashikimet e të hyrave operuese;
- c) Procesverbali i mbledhjes së komitetit konsultativ;
- d) Marrëveshja mbi nivelin e shërbimit, nëse aplikohet;
- e) Plani investues dhe financimi i tij.

### **Neni 13**

#### **Vendimet e AAC-së**

- 13.1 Nëse AAC-ja përcakton se tarifafat e propozuara të aeroportit janë në pajtim me parimet e tarifave të përcaktuara në nenet 3, 4, 7, 8, 10 dhe 11, Drejtori i Përgjithshëm do të nxjerrë një vendim për aprovimin e tarifave të aeroportit. Ky vendim do të specifikojë nivelet e reja të tarifave të aeroportit të aplikueshme në aeroporte të caktuara dhe datën e hyrjes së tyre në fuqi.
- 13.2 Nëse AAC-ja përcakton se tarifafat e propozuara të aeroportit nuk janë në pajtim me parimet e tarifave të përcaktuara në nenet 3, 4, 7, 8, 10 dhe 11, Drejtori i Përgjithshëm do të kërkojë nga organi menaxhues i aeroportit që të modifikojë propozimin e vet në pajtueshmëri me këtë Rregullore dhe ta dorëzojë atë sërish për aprovim tek AAC-ja. Në rast se organi menaxhues i aeroportit nuk vepron sipas kërkesave nga ky paragraf, atëherë AAC mund të refuzojë aprovimin e tarifave me vendim.
- 13.3 Organi menaxhues i aeroportit duhet t'u japë së paku një (1) muaj njoftim paraprak përdoruesve për sistemin e ri të tarifave, nivelet e tyre, ndryshimin ose modulimin, nëse janë të aplikueshëm, dhe datën e hyrjes së tyre në fuqi.
- 13.4 AAC-ja do të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit vendimet më aktuale mbi aprovimin e tarifave menjëherë pasi që ato të hyjnë në fuqi.
- 13.5 Sa i përket Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", niveli i tarifave duhet të bazohet në dispozitat e Marrëveshjes PPP, gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 14**

#### **Raportimi vjetor në AAC**

Pas përfundimit të vitit të parë financiar dhe të çdo viti më pas, organi menaxhues i aeroportit duhet t'i dorëzojë pasqyrat e tij financiare të audituara për vitin paraprak në AAC për shqyrtim më së largu deri më 31 mars.

Pas fillimit të operimeve dhe çdo vit më pas, organi menaxhues i aeroportit duhet të dorëzojë policën e tij të sigurimit që mbulon përgjegjësinë që del nga operimet aeronautike tek AAC-ja më së voni një (1) javë pas ditës së fillimit të

mbulueshmërisë me policën e sigurimit.

### **Neni 15** **Mjetet juridike**

Palët mund të kërkojnë rishqyrtim të vendimeve të nxjerrura sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së.

### **Neni 16** **Përjashtimet**

16.1 Nga pagesa e tarifave të aeroportit përjashtohen:

- a) Mjetet ajrore që janë të përfshira në aktivitete operationale të kërkim-shpëtimit të ndërlidhura me incidentet që përfshijnë aviacionin civil;
- b) Mjetet ajrore që përdoren për ndihmë humanitare në rast të katastrofave natyrore apo emergjencave shtetërore, dhe
- c) Mjetet ajrore në rrezik.

16.2 Përjashtimet e dhëna në paragrafin e lartpërmendur mund të anulohen nga AAC-ja në pajtim me nenin 82.2 të Ligjit Nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil.

### **Neni 17** **Rregullim i veçantë për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" duhet të zbatohen në përputhje me Marrëveshjen e PPP-së, gjatë kohës sa kjo marrëveshje është në fuqi.

### **Neni 18** **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 1/2011 mbi tarifatat e aeroportit, e datës 18 janar 2011.

### **Neni 19** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i Përgjithshëm

Prishtinë, 8 qershor 2015